



E K S T R A K T

I mbledhjes së shtatë i Komitetit për Komunitete, mbajtur më 20.7.2023 me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Elmira Nikçi Rexha, Nenad Miladinovic, Oktay Kurtesh, Kimeta Shok, Faton Marolli.

Munguan: Arton Brahim, Trier Kasumi, Adnan Ajeti.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Ardita Kafexholli - zyrtare nga Drejtoria e Shëndetësisë, Eroll Raskova - zyrtar i Drejtorisë së Financave, Klaudia Mula - zyrtare nga ZKKK-s, Fisnik Dida - zyrtar nga OSBE, Arianita Beqa – Rraci - zyrtare nga UNMIK-u.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e komitetit znj. Mirsada Behluli, me këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë, z. Izet Sadiku:
 - a) ofrimi i shërbimeve shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë,
 - b) zbatimi i programit të vaksinimit për fëmijët e komunitetit ashkali dhe rom;
3. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Financave znj. Valbona Makolli, Informatë lidhur me ndarjen e buxhetit për vitin 2023;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit gjashtëmuor për punën e Komitetit për Komunitete;
5. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave në një periudhë gjashtëmuore;
6. Raporti i ZKKK-s për muajin qershor 2023;
7. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre;
8. Të ndryshme.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së.

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë

Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë, z. Izet Sadiku:

- a) ofrimi i shërbimeve shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë,
- b) zbatimi i programit të vaksinimit për fëmijët e komunitetit ashkali dhe rom.

Mirsada Behluli – duke u bazuar në rendin e ditës të cilin e keni përpara, ajo iu drejtua zyrtares së shëndetësisë duke pyetur se çka mund të na informoni lidhur me shërbimet e sipërcekura që kanë të bëjnë me komunitetet joshumicë.

Ardita Kafexholli - zyrtare nga Drejtoria e Shëndetësisë – lidhur me pyetjen e shtruar nga znj. Behluli tha se kërkoj falje, por nuk mund t'ju jap përgjigje pasi që në momentin e fundit jam informuar se do të jem pjesë e takimit, si dhe nuk kam qenë e njoftuar lidhur me pyetjet që i keni shtruar. Mirëpo unë mund t'i marr kërkesat e juaja dhe t'i përcjelli tek drejtori.

Nenad Miladinovic – shtroi pyetje lidhur me trajtimin e mushkonjave ku tha se a ekziston ndonjë plan lidhur me trajtimin e mushkonjave nga drejtoria e juaj, po që se ekziston a janë të informuar qytetarët se kur është planifikuar trajtimi dhe në cilin territor, pasi që më herët janë informuar saktë për kohën dhe datën e dezinfektimit.

Ardita Kafexholli – sa i përket trajtimit të mushkonjave tha se ajo veçse ka filluar dhe është në fazën e tretë të trajtimit, si dhe trajtimi i mushkonjave është ndarë në gjashtë faza. Shkaku pse është shtyrë këtë vit është për shkak të kushteve klimatike d.m.th ka pasur të reshura të cilat e kanë bërë shpëlarjen e trajtimit, ndërsa sa i përket planifikimit mund të them se është planifikuar kohë më parë ku trajtimi fillon prej orës 7:00 në mëngjes dhe lajmërimin mundeni ta merrni edhe prej faqes zyrtare të Drejtorisë së Shëndetësisë, meqë ka pasur njoftime përmes mediave, radios, si dhe drejtori ka pasur shumë intervista, ku për çdo ditë bëhet termini se në cilën lagje do të bëhet trajtimi.

Nenad Miladinovic – tha se vërejtja ime është se shumë po vononi me këtë tretman, pasi që disa komuna më të vogla atë veç e kanë kryer qysh para 15-20 ditëve. Ai në vazhdim tha se më parë Komuna e Prishtinës ka qenë gjithmonë e para sa i përket trajtimit të mushkonjave, ndërsa sa i përket të reshurave ka një muaj që nuk kemi të reshura, është temperaturë e lartë, mushkonja ka së tepërmi dhe kjo gjendje nuk ka guxuar të zgjatë aq shumë.

Ardita Kafexholli - sa i përket komunave të tjera tha se nuk e di se kur kanë filluar ato, por edhe Komuna e Prishtinës ka filluar që në muajin qershor.

Kimeta Shok – shtroi pyetje përse trajtimi i mushkonjave bëhet në orën 21:00 kur njerëzit dalin e shëtitin.

Klaudia Mula – të pranishmit i informoi se në seancën e fundit të Kuvendit është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Avancimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ku ky Plan i ka të përshkuara aktivitetet për të cilat drejtoritë përkatëse janë përgjegjëse për implementimin e tyre. Sa i përket Drejtorisë së Shëndetësisë janë disa aktivitete të cilat kam dëshirë t'i lexoj. Këto aktivitete do t'i përcjelli edhe zyrtarisht me e-mail drejtorit, por unë kisha pasur dëshirë edhe këtu t'ju njoftoj rreth komuniteteve. Aktiviteti i parë që është në objektivin tre, e që lidhet me përmirësimin e shëndetit të

pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali, egjiptian dhe rritja e qasjes së barabartë në shërbimet cilësore shëndetësore, janë si në vijim:

- Organizimi i vizitave periodike shëndetësore në familjet e komuniteteve nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare.
- Identifikimi i fëmijëve të paimunizuar dhe imunizimi i tyre.
- Organizimi i ligjëratave rreth edukimit shëndetësor dhe planifikimit familjar.
- Organizimi i fushatave vetëdijesuese për shërbimet që ofrojnë Qendrat e Mjekësisë Familjare.
- Organizimi i vizitave periodike për mamografi, si dhe
- Organizimi i fushatave vetëdijesuese për ndërgjegjësimin e stafit shëndetësor për trajtim të barabartë të pacientëve.

Këto aktivitete janë paraparë në plan, për të cilat e keni mbështetjen dhe mund të gjeni bashkëpunimin e plotë me Zyrën për Komunitete gjatë implementimit.

Mirsada Behluli – sa i përket dezinfektimit tha se kisha për të përmendur se kemi shumë probleme në lagje me mbeturinat dhe a kishit mundur të na thoni se çka mund të ndërmerrni lidhur me këtë çështje. Ajo në vazhdim shtroi pyetje se sa janë të përfshira komunitetet joshumicë në institucionet shëndetësore pasi që ka prej tyre që e kanë kryer shkollën e mesme të mjekësisë e që janë të papunë, si: fizioterapistë, traumatologë, etj., që do të thotë se duhet t'i keni parasysh edhe komunitetet.

Pika e tretë

Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Financave znj. Valbona Makolli, informatë lidhur me ndarjen e buxhetit për vitin 2023

Eroll Raskova - në bazë të një klauzole të bazuar në buxhetin e Ministrisë së Financave, Zyra për Komunitete e ka të paraparë buxhetin qysh edhe prej më herët ku çdo vit e ka pasur buxhetimin e limituar, pra çdo vit duhet ta kemi të paraparë buxhetin në kuadër të Zyrës për Komunitete. Ne këtë buxhet në vazhdimësi e kemi ndarë në tri kategori, në kategorinë paga dhe mëditje ku janë paraparë 30 mijë euro, kategoria e dytë mallra dhe shërbime ku janë të parapara 120 mijë euro dhe kategoria e tretë janë shpenzimet komunale, për të cilën kategori janë të parapara 18 mijë euro e që në total vlera është 160 mijë euro. Ai në mes tjerash tha se në harmoni me komunitetet ata parashohin projekte e këto projekte janë të buxhetuara në ato drejtori, kështu që ky është buxheti për vitin 2023. Gjithashtu edhe për vitet 2024/2025 sipas klauzolës duhet të jetë në këto vlera, vetëm se kjo paga dhe mëditje këta pesë punëtorë në bazë të Ligjit të Pagave është se duhet rritur pak.

Klaudia Mula – duke iu drejtuar z. Raskova tha se nuk e keni cekur vlerën e investimeve kapitale.

Eroll Raskova – tha se sa i përket investimeve kapitale varet prej drejtorisë dhe kërkesave të juaja në atë drejtori për kryerjen e atij projekti.

Klaudia Mula - tha se vlera është e caktuar 100 mijë euro çdo vit, por mund të kalohet. Kjo vlerë do të shkojë nëpër lagjet ku jetojnë komunitetet joshumicë.

Eroll Raskova - tha se edhe më herët e thash se në bazë të drejtorive ka pasur edhe 100 mijë, edhe 200 mijë euro, por tash ato janë të shkrira në bazë të interesave për komunitetet se nuk mund t'i caktojmë sepse nëse janë interesat e mëdha i tejkalon edhe vlerat.

Nenad Miladinovic – tha se sa i përket raportimit të zyrtarit nga drejtoria e financave plotësisht pajtohem me të dhe e përkrahi për shkak se e di se si funksionon gjatë gjithë këtyre viteve. E vetmja që më intereson prej kësaj është pagesa e mëditjeve se çka është duke ndodhur me to. Ndërsa sa i përket projekteve për investime kapitale, caktimit të këtij buxheti nga Drejtoria e Financave dhe bashkëpunimit me Drejtorinë e Investimeve Kapitale nuk kam asnjë vërejtje.

Eroll Raskova – duke iu përgjigjur pyetjes së Nenadit tha se kategoria e pagave dhe mëditjeve është e centralizuar prej Ministrisë së Financave që d.m.th., krejt atë kategori e ka Ministria e Financave. Ndërkaq për çështjen e pagesës së anëtarëve të Komisionit do të bisedoj edhe njëherë me Arbrin.

Kimeta Shok – shtroi çështjen e mospagesës së mëditjeve ku tha se kjo më herët nuk ka ndodhur dhe luteni që të ndërmerrni diçka lidhur me këtë.

Pika e katërt

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit gjashtëmuor për punën e Komunitetit për Komunitete

Njëzëri u miratua Raporti gjashtëmuor i punës së Komitetit për Komunitete.

Pika e pestë

Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave në një periudhë gjashtëmuore

Klaudia Mula - tha se sa i përket kësaj pike këto janë të përfshira të gjitha në raportin gjashtëmuor të Komitetit për Komunitete dhe të gjitha kërkesat janë deleguar nëpër drejtoritë përkatëse duke shtuar se për çdo përgjigje jeni të informuar edhe ju si ZKKK-s ashtu edhe Komiteti për Komunitete.

Nenad Miladinovic - tha se në takimin e fundit e kemi pasur drejtorin e shërbimeve publike i cili ka thënë se duhet të dërgohet një kërkesë për pastrimin e shtratit të lumit në Bërnice të Poshtme. Betimi ka thënë se ai do ta përcjellë atë kërkesë dhe po më intereson se a e ka kryer obligimin.

Klaudia Mula – tha se meqë unë kam qenë në pushim dhe nuk jam shumë e njoftuar lidhur me këtë, do të interesohem dhe do t'ju informoj me e-mail.

Nenad Miladinovic – tha se nëse nuk është dorëzuar kërkesa ende, atëherë kisha për ta lutur Klaudien që ta marrë përsipër dhe ta dorëzojë.

Pika e gjashtë

Raporti i ZKKK-s për muajin qershor 2023

Klaudia Mula – sa i përket raportit muor të ZKKK-s për muajin qershor, tha se mendoj se e keni lexuar të gjithë. Por ajo çka vlen të theksohet dhe është një sukses i ZKKK-s është miratimi i Planit Lokal të Veprimit për Avancimin e Komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian në Komunën e Prishtinës 2023/2026. Ajo në vazhdim tha se kemi punuar shumë në hartimin e këtij plani, kështu që aktivitetet tjera janë zhvilluar në bazë të Planit të punës së ZKKK-s.

Njëzëri u miratua Raporti i ZKKK-s për muajin Qershor 2023.

Pika e shtatë

Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre

Kimeta Shok – paraqiti problemin lidhur me regjistrimin e fëmijëve në fakultet duke theksuar se vendet janë të limituara, si dhe janë të obliguar të sjellin vërtetimet me të cilat identifikohen se janë goranë, boshnjakë etj., kurse atë lloj vërtetimi nuk po mund ta marrin në Komunë. Prandaj ajo shtroi pyetje përse qytetarët nuk mund të pajisen me at vërtetim nga Komuna, ku për shkak të këtij vërtetimi vendet të cilat janë të limituara për komunitetet po zihen.

Klaudia Mula – sa i përket vendeve të limituara për regjistrim në universitet Komuna e Prishtinës nuk është përgjegjëse për këtë çështje dhe unë po kaloj në atë për çka ne jemi kompetentë. Njëherazi sa i përket vërtetimeve që i kanë kërkuar nxënësit për ta identifikuar identitetin e tyre tha se këto merren nëpër bashkësi lokale. Ajo në vazhdim tha se para dy ditëve ka biseduar me shefin e bashkësive lokale dhe ai më tregoi se duhet të merret një vërtetim prej partive politike të atij komuniteti dhe një faturë e shërbimeve komunale dhe të shkojnë nëpër bashkësitë e tyre lokale dhe aty mund ta marrin vërtetimin pa problem. Pra këto janë kriteret që duhet plotësuar për t'u marrë ai vërtetim. Tek ju znj. Kimeta unë i kam udhëzuar personalisht sepse ata deklaruan se janë të komunitetit goran, edhe mendova se ju si përfaqësuese e komunitetit goran mund t'i udhëzoni drejt tek partia e juaj politike që ata të marrin një vërtetim se janë të komunitetit goran. Ndërsa zyrtarët komunalë nuk mund të lëshojnë vërtetime pa ndonjë dëshmi të paktën nga partitë që i takojnë atij komuniteti sepse po ka shumë keqpërdorime.

Mirsada Behluli – tha se më herët ka qenë që janë kontaktuar përfaqësuesit e komuniteteve për t'i vërtetuar pjesëtarët e vet, ndërsa sa i përket identifikimit përmes partive politike ka edhe keqpërdorime.

Klaudia Mula - tha se do të ishte mirë që për takimin e ardhshëm të ftohet shefi i bashkësive lokale ose drejtori i administratës, që të diskutohet kjo çështje dhe ta gjejnë një zgjidhje.

Nenad Miladinovic – tha se është me rëndësi meqë ne jemi të gjithë përfaqësues të komuniteteve tona dhe për të gjitha programet, projektet të cilat shkojnë për komunitetet, së pari duhet të jemi të informuar ne si përfaqësues dhe ato duhet të shkojnë përmes neve. Pas ca diskutimesh dhe sugjerimesh Komiteti për Komunitete mori vendim që për mbledhjen e radhës të ftohet drejtori i administratës.

Pika e tetë

Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Pas shumë diskutimesh dhe sugjerimesh Komiteti për Komunitete nxorri këto;

REKOMANDIME

1. Të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë për seancën e 8-të të KK të përgatisin listat e familjeve në kushtet të rënda socio-ekonomike që kanë nevojë për material për ngrohje me të dhëna të sakta të xhiro llogarisë, adresën dhe numrin e telefonit për të shmangur gabimet e mëparshme.

2. Ftesë për kryetarin e komunës së Prishtinës z. Përparim Rama a) diskutim rreth projekteve për vitin 2023

b) shpenzimi i mjeteve për komunitetet nga buxheti i komunës së Prishtinës c) respektimi i të drejtave të komuniteteve joshumicë, sfidat - mëditjet të papaguara për mbledhjet e KK të mbajtura nga shkurti 2023, të cilat janë ndërprerë.

3. Ftesë për Drejtorinë e Administratës: a) numri i personave të regjistruar të komunitetit Ashkalij dhe Rom.

b) problemi lidhur me lëshimin e dokumenteve personale në gjuhët e komunitetit turk dhe serb.

Mbledhja e radhës do të mbahet më 25 shtator 2023, me fillim nga ora 10:00.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15

**Procesmbajtësja
Lendita Spahija**

**Kryesuesja e Komitetit
Dr. Mirsada Behluli**

